



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

Data 10.10.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Blerje kompjutera për vitin 2023”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

FPP: 30191000-4 Pajisje zyre përveç mobiljeve

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

3,311,547 lekë (tre milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë ) Lekë pa TVSH

Në zbatim të Nenin 21 pika 1, Neni 2, pika 2 c), Neni 33, Neni 41, pika 1 ë) dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020, ”Për Prokurimin Publik”, Nenin 11, dhe Nenin 78 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore ka hartuar proces verbalin për hartimin, argumentimin dhe miratimin e kriterëve të veçanta për kualifikim me përmbajtjen si më poshtë

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### *a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

**Argumentimi:**Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

#### *b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;*

**Argumentimi:**Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

#### *c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

#### *d.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*

**Argumentimi:**Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Certifikatë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”/ ekuivalent
- b) Certifikatë ISO 27001:2013 mbi “Menaxhimin e sigurisë së informacionit”/ ekuivalent

Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin provues: Certifikatat origjinale ose kopje e noterizuar, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e certifikatave.

**Argumentimi:** Ky kriter i percaktuar është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të percaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.* Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku percaktohet se: *1. Autoriteti/entikontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.* Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

Përmbushja e standardeve ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara

dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, 2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

**3,311,547 x 0,4=1,324,618 (një milion e treqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë ) lekë pa tvsh.**

**Argumentimi:** Ky kriter, është vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku percaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...". Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.*

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e vlerës së perlllogaritur të kontratës. Për të provuar aftësinë /përshtatshmërinë profesionale të OE, AK duke analizuar rast pas rasti bazuar në parimin e proporcionalitetit në objektin e kontratës që do të prokurohet, ka gjykuar të arsyeshme përcaktimin e kësaj vlere për të krijuar besueshmërinë e nevojshme në kapacitetet profesionale të OE. Në këtë mënyrë AK krjon bindjen e përgjithshme në aftësinë profesionale të OE duke u bazuar në përvojat e mëparshme të tij realizuar në sektorin privat/publik për të marrë përsipër realizimin dhe zbatimin e objektit të kontratës që do të prokurohet

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njepasnjeshme nuk ka raporte negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilance i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv paraqesin vërtetësi dhe besueshmëri në pozicionin financiar të operatorit ekonomik.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit** dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislatorit në fuqi, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të percaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me pikën 4 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilin është e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

**2.3.2** Operatori ekonomik minimalisht 3 muaj e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, duhet të ketë të punësuar 2 punonjës të certifikuar si më poshtë,

- a) 1 (një) punonjës të certifikuar në MSCE për Infrastrukturë Desktop;
- b) 1 (një) Inxhinier elektronik të certifikuar ITIL për menaxhimin e shërbimeve IT;

Për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues:

- kontratën e punës,
- Certifikatën përkatëse.

**Argumentimi :** Kërkesat janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 5/b) dhe c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, konkretisht për instalimin/konfigurimin e pajisjeve, si dhe gjatë periudhës së garancise të parashikuar në specifikimet teknike.

Për këtë është kërkuar që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës kanë patur pjesë të stafit të tyre personel përkatësisht sipas kategorive të kërkuara. Kjo kërkesë synon të garantojë autoritetin kontraktor se kapacitetet njerëzore janë pjesë e përvojës së operatorit ekonomik ofertues dhe si të tilla rrisin sigurinë për të përmbushur dhe zbatuar kontratën objekt prokurimi brenda afateve të parashikuara dhe në cilësinë e kërkuar.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/distributori i autorizuar për tregtimin e artikujve objekt prokurimi (sipas tabelës përmbledhëse). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu, Autorizimi i prodhuesit/distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga

prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

## II. Argumentimi i Specifikimeve Teknike

### Shtojca 5.

#### 1. Qëllimi :

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, kërkon të realizoj blerjen e kompjuterave të nevojshëm për mbarëvajtjen e punës në institucion. Me realizimin e blerjes së kompjuterave synohet sigurimi i kushteve normale të punës për punonjësit e institucionit.

#### 2. Objekti :

Realizimi i blerjes së materialeve të mësipërm, do t'u vij në ndihmë punonjësve të institucionit në kryerjen e proceseve normale të punës dhe përmbushjes së detyrave funksionale të gjithësecilit prej tyre.

#### 3. Detyrat:

Autoriteti Kontraktor ka për detyrë të realizoj blerjen e kompjuterave sipas sasisë dhe specifikimeve të kërkuara nga Drejtoria e IT, Mediave dhe Statistikës.

#### 4. Vendi i kryerjes së furnizimit:

Në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë.

#### 5. Specifikimet teknike :

KOMPJUTER DESKTOP 1

#### KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

**Pikët Min. për Procesorin sipas:**

7900 Pikë

**cpubenchmark.net Min Proc. Rating**



<b>“RAM”:</b>	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
<b>Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:</b>	500 GB SSD
<b>“Disk Subsystem Controller”:</b>	Serial ATA III 6 Gb/s
<b>Karta Grafike “Graphics”:</b>	Integrated graphic Card, min. 1 GB
<b>“Media Device”:</b>	DVD+/-RĒ
<b>“Slots”:</b>	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E
<b>KOMUNIKIMI &amp;</b>	
<b>Portat e Komunikimit “Ports”:</b>	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
<b>Rrjeti “Networking”:</b>	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
<b>“Sound”:</b>	Integrated Sound Card
<b>“Speakers”:</b>	Internal or Built-in Monitor
<b>Siguria “Security Management”:</b>	Embedded Security TPM 2.0
<b>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:</b>	OEM ëindoës 10 64-bit Professional
<b>Tastiera “Keyboard”:</b>	Standart Keyboard QĒERTY
<b>“Mouse”:</b>	Minimum 3 Button Scroll Optical
<b>Ushqimi “Poëer Supply”</b>	220 V AC, 50 Hz
<b>Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:</b>	Energy Star
<b>AKSESORËT</b>	
<b>Kabëll “Poëer Cord”:</b>	Po, European
<b>“Recover”:</b>	Recover Partition
<b>MONITORI</b>	
<b>Tipi “Type”:</b>	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me
<b>Madhësia “Size”:</b>	≥ 21”
<b>Rezolucioni “Native Resolution”:</b>	1920 x 1080 at 60 Hz
<b>Raporti i Kontratit “Constrast Ratio Static”:</b>	1000:1
<b>“Display Port”:</b>	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave
<b>Koha e Rifreskimit “Response Time”:</b>	≤ 6 ms
<b>Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:</b>	Energy Star
<b>Ushqimi “Poëer Supply”:</b>	220 V AC, 50 Hz
<b>GARANCIA</b>	
<b>Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ēarranty”:</b>	3 Vjet

6.

## KOMPJUTER ËORKSTATION (SIPAS PRODHUESIT)

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
<b>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating</b>	10000 Pikë
<b>“RAM”:</b>	16 GB, min. DDR4-2666 MHz, ECC
<b>Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:</b>	(1) x 256 GB SSD Sistemi Operativ dhe (2) x 1000 GB HDD
<b>Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”:</b>	7200 RPM SATA 6.0 Gb/s për HDD
<b>“Disk Subsystem Controller”:</b>	Serial ATA III 6.0 Gb/s, Minimum 4 Serial ATA Interface ëith RAID 0,1,5,10 Support. (Hard Disk të Konfiguruar në RAID 1)
<b>Karta Grafike “Graphics”:</b>	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 2 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për ëorkstation.
<b>“Media Device”:</b>	DVD+/-RË ëith Dual Layer DVD+R ëri.
<b>“Slots”:</b>	Minimum (4) PCI/PCI-E nga të cilat min. (2)
<b>KOMUNIKIMI &amp;</b>	
<b>Portat e Komunikimit “Ports”:</b>	Min. (8) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (6) USB 3.0 (2) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor)
<b>Rrjeti “Netëorking”:</b>	(2) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port
<b>“Sound”:</b>	Integrated Sound Card
<b>“Speakers”:</b>	Internal speakers or Built-in Monitor
<b>Siguria “Security Management”:</b>	Embedded Security TPM 2.0
<b>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:</b>	OEM ëindoës 10 64-bit Professional për
<b>Tastiera “Keyboard”:</b>	Standart Keyboard QËERTY
<b>“Mouse”:</b>	Minimum 3 Button Scroll Optical
<b>Ushqimi “Poëer Supply”:</b>	220 V AC, 50 Hz
<b>Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”:</b>	Energy Star
<b>AKSESORËT</b>	
<b>Kabëll “Poëer Cord”:</b>	Po, European
<b>“Recover”:</b>	Recover Partition
<b>MONITORI</b>	
<b>Tipi “Type”:</b>	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me

<b>Madhësia “Size”:</b>	≥ 23"
<b>Rezolucioni “Native Resolution”:</b>	1920 x 1080 @ 60 Hz
<b>Raporti i Kontrastit “Constrast Ratio Static”:</b>	1000:1
<b>Koha e Rifreskimit “Response Time”:</b>	≤ 6 ms
<b>“Display Port”:</b>	(1) VGA ose DVI dhe (1) prej Portave
<b>Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:</b>	Energy Star
<b>Ushqimi “Poëer Supply”:</b>	220 V AC, 50 Hz
<b>GARANCIA</b>	
<b>Periudha e Mbulimit të Garancisë “ëarranty”:</b>	3 Vjet

## LAPTOP BASIC

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
<b>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating</b>	4500 Pikë
<b>“Chipset”:</b>	Intel ose Ekuivalent
<b>“RAM”:</b>	8 GB, DDR4 min. 2133 MHz, Non-ECC
<b>Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:</b>	256 GB SSD
<b>“Graphics”:</b>	Integrated Graphics ëith 1 GB Video Memory
<b>Ekрани “Display”:</b>	15.6” LED FHD (1920 x 1080), Anti Glare
<b>Bateria “Battery”:</b>	Min. 45 ëh
<b>KOMUNIKIMI &amp;</b>	
<b>Portat e Komunikimit “Ports”:</b>	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0 (1) DisplayPort/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD ëeb Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
<b>Rrjeti “Netëorking”:</b>	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); ëireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n); Bluetooth min. V4.0
<b>“Sound”:</b>	Integrated , (2) x built-in speakers (stereo)
<b>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:</b>	OEM ëindoës 10 64-bit Professional
<b>Tastiera “Keyboard”:</b>	QëERTY
<b>“Pointing Device”:</b>	Touch Pad
<b>Siguria “Security Management”:</b>	Embedded Security TPM 2.0
<b>AKSESORËT</b>	

Kabëll “Poëer Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”:	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
<b>GARANCIA</b>	
Periodha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:	3 Vjet

Afati i lëvrimit të mallit (ku të përfshihet instalimi dhe konfigurimi) 20 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

**Specifikimet teknike janë hartuar referuar nevojave të AK DHE pjesërisht standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shqipërisë së Informacionit.**

## FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Njësia
1.	Kompjuter Desktop 1	21	copë
2.	Kompjuter workstation (sipas prodhuesit)	1	copë
3.	Laptop Basic	2	copë

Afati i lëvrimit të mallit (ku të përfshihet instalimi dhe konfigurimi) 20 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

**Argumentimi:** Sasia dhe Grafiku i lëvrimit janë vendosur referuar shkresës Nr.110647/3 Prot., date 29.09.2023 “Relacion mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe perlloraritjen e e fondit limit per proceduren e prokurimit me objekt : **“Blerje kompjutera për vitin 2023”**, si dhe ne perputhje

me piken 3, germa b te nenit 15 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

**BORA STEFANIDHI**

**ONEDA XHAJA**

**MARJOLA GJERAZI**